



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 21/2013
Datë: 27.02.2013

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Memli Krasniqi, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7 (shtatë) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe u mbështetur në nenin 3 (paragrafi 8), nenin 4 (paragrafi 14, 15, 17, 19 dhe 20), dhe nenin 6 (paragrafi 5) të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, më datën 12.02.2013, mori këtë :

V E N D I M

1. Mbetet ne fuqi Vendimi më nr. 19/2013 të datës 07.02.2013 për ndërprejen e punimeve në Hamamin e Prishtinës.
2. Obligohet organi mbikëqyrës se bashku me anëtar të komisionit të inicioj procedurën për marrjen e mostrave për analiza laboratorike të katër shtresave (gjendjes ekzistuese, shtresës së spërkatjes, shtresës së parë dhe shtresës se dytë të suvasë).
3. Nga laboratori, përveç përqindjes së përbërësve, të sjellet edhe përshkrimi i materialeve të përdorura dhe të përgatitet raporti i përbërësve.
4. Duke u bazuar në rezultatet e analizave laboratorike, pas rekomandimit të Komisionit do të vendos për ndërmarrjen e hapave të mëtutjeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Hamami i Prishtinës si objekt i ndërtuar në shek. XV është shpallur monument kulture me nr.v. E.K. 0301-632/85, po ashtu ky monument gjendet edhe ne Listën e Trashëgimisë Kulturore të nënshkruar nga Ministri, Z. Memli Krasniqi në Tetor 2012. Punimet e Konservimit dhe Restaurimit të Hamamit të Prishtinës kanë filluar që nga viti 2007 të iniciuara nga K.K. i Prishtinës, fillimisht për pastrimin e hapësirës së Hamamit për të vazhduar më pas nga viti 2009 me realizimin e punëve konservuese dhe restauruese punime te cilat filluan të realizohen në bazë të planit të studimit dhe restaurimit projektit të punuar nga CHWB.

Gjatë realizimit të këtyre fazave ka pasur vërejtje të ndryshme nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar për ndryshimin e pozicioneve të projektit për te cilën gjë ekzistojnë edhe raportet zyrtare, mirëpo, asnjëherë nuk është iniciuar proceduar e revidimit të projektit.

Me kërkesën Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave – Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore ne vitin 2010 ka dhënë pëlqimi për ridestinimin e objektit në Muze të Prishtinës.

Pas ridestinimit të objektit KK i Prishtinës ka iniciuar procedurën për kompletimin e fazave, instalimeve të objektit. Projekti i instalimeve asnjëherë nuk është paraqitur në Komision, që do të thotë nuk ka pëlqim nga Komisioni.

Me 28.01.2013 Komision është takuar për shqyrtimin lëndës së hamamit, lidhur me zbatimin e punimeve në Hamamin e Prishtinës bazuar në bregat e qytetarëve si dhe raportin e ekspertëve të QRTK Prishtine të datës 24/25 Janar 2013. Në këtë takim Komisioni ka lexuar raportin e QRTK Prishtinë, dhe pas diskutimit të raportit anëtarët e komisionit kanë kërkuar që të bëhet shqyrtimi i dokumentacionit të projektit zbatues për të verifikuar se a janë duke u realizuar pozicionet sipas projektit.

Në bazë të dokumentacionit dhe vizitës në terren Komisioni ka konstatuar se punimet janë duke u realizuar në kundërshtim me ligjin për Trashëgimisë Kulturore dhe në kundërshtim me normat profesionale për restaurim dhe konservim, dhe për këtë komisioni ka rekomanduar ndërprerjen e menjëhershme të punimeve.

Me 20.02.2013 në takimin e komisionit është prezantuar analiza e llaçit të iniciuar nga vet kompania ekzekutuese, dhe pas prezantimit të analizës kimike të llaçit të punuar nga Instituti INKOS, Komisioni ka vërejtur që përveç përqindjeve të parametrave të prezantuara, nuk kishte ndonjë raport përshkruar të përbërjes së materialit. Përkundër faktit që raporti i analizës kimike të materialit nuk ishte komplet, komisioni vërejtë ndryshime shumë të mëdha të parametrave në strukturën e llaçit ekzistues dhe llaçit te ekzekutuar gjate kësaj faze dhe duke u bazuar në këtë është nxjerr ky Vendim.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekt Propozimeve për Ndërhyrje Restauruese-Konservuese;
- Departamentit të Trashëgimisë;
- QRTK-së Prishtinë;
- Komunës se Prishtinës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së;

